

# STATISTIKAT E ARSIMIT

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

INSTAT

## Metadate Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave .....	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse .....	5
5. Periudha e referencës .....	5
6. Mandati institucional.....	5
7. Konfidencialiteti .....	6
8. Politika e botimit.....	6
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	7
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia .....	7
11. Manaxhimi i cilësisë .....	8
12. Rëndësia.....	8
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	9
14. Afatet kohore dhe përpikmëria .....	9
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	9
16. Kostoja dhe ngarkesa .....	10
17. Rishikimi i të dhënave.....	10
18. Përpunimi statistikor .....	10
19. Komente.....	11
Aneks .....	11

<b>1. Kontakt</b>	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Zhvillimit të Statistikave Sociale, Drejtoria e Statistikave Sociale
1.3. Personi i kontaktit	Elda Muça
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialist, Sektori i Zhvillimit të Statistikave Sociale
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	<a href="mailto:emuca@instat.gov.al">emuca@instat.gov.al</a>
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
<b>2. Përditësimi i metadatave</b>	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	14/05/2021
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	15/05/2020
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	14/05/2021
<b>3. Paraqitja statistikore</b>	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p><b>Regjistrimet në arsim</b></p> <p>INSTAT organizon punën për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave mbi regjistrimet e fëmijëve, nxënësve dhe studentëve në arsimin zyrtar, bazuar në Programin e Statistikave Zyrtare dhe Ligjin e Statistikës. Mbi bazën e informacionit të mbledhur kryhet llogaritja e treguesve dhe publikimi i statistikave të regjistrimeve. Informacioni mblidhet nga çdo njësi që ofron shërbimin arsimor publik ose privat në vend si kopshte, shkolla, universitete, kolegje etj. Informacioni i mbledhur për arsimin parauniversitar kalon nga njësitë bazë në drejtoritë dhe zyrat arsimore dhe nëpërmjet tyre në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, veçanërisht për arsimin profesional. Këto dy Ministri i përcjellin INSTAT në formën e tabelave të përmbledhura në Excel të gjithë informacionin e grumbulluar. Informacioni mblidhet dhe përpunohet sipas niveleve arsimore. Të dhënat për regjistrimet e arsimit të lartë mblidhen nga Ministria e Arsimit,</p>

	<p>Sportit dhe Rinisë direkt nga shkollat e larta, universitete ose kolegje dhe po ashtu në formën e tabelave të përmbledhura në Excel i vihen në dispozicion INSTAT-it.</p> <p><b>Diplomimet në arsim</b> Në njëjtën mënyrë procedohet edhe me diplomimet. Burim informacioni janë dy ministritë e lartpërmendura. Tabelat e diplomimeve po ashtu vijnë në INSTAT si tabela përmbledhëse Exceli, të cilat përpunohen më tej deri në llogaritjen e treguesve dhe publikimin e tyre. Informacioni mblidhet dhe përpunohet sipas niveleve arsimore.</p> <p><b>Stafi mësimdhënës</b> Informacioni mblidhet dhe përpunohet sipas niveleve arsimore dhe llogariten treguesit lidhur me nxënësit ose studentët.</p> <p><b>Institucionet arsimore</b> Informacioni mblidhet dhe përpunohet sipas niveleve arsimore dhe llogariten treguesit sipas institucioneve arsimore etj.</p>
<p>3.2. Sistemi i klasifikimit</p>	<p>Statistikat e arsimit përpunohen dhe publikohen sipas klasifikimit <a href="#">ISCED-2011</a>.</p> <p>Arsimi në Shqipëri është i organizuar sipas këtyre programeve dhe klasifikuar sipas Klasifikimit ISCED-2011 që përdoret ndërkombëtarisht në statistikat e arsimit :</p> <p>Niveli 0 - Arsimi parashkollor – çerdhe / kopshte</p> <p>Niveli 1 - Arsimi fillor ose cikli i ulët i arsimit bazë</p> <p>Niveli 2 - Arsimi i mesëm i ulët ose cikli i lartë i arsimit bazë</p> <p>Niveli 3 - Arsimi i mesëm i lartë - Gjimnaz / Profesional / Social kulturor</p> <p>Niveli 4 - Arsimi pas të mesmes por jo i lartë</p> <p>Niveli 5 - Arsimi i lartë cikël i shkurtër</p> <p>Niveli 6 - Bachelor ose ekuivalent</p> <p>Niveli 7 - Master ose ekuivalent</p> <p>Niveli 8 - Doktoraturë ose ekuivalent</p> <p>Klasifikimi i Fushave të studimit për arsimin e lartë bëhet në bazë të <a href="#">ISCED-F 2013</a>, ku grupimet kryesore janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1- Shkenca arsimi</li> <li>2- Arte dhe Shkenca humane</li> <li>3- Shkenca sociale, Gazetari dhe Informacion</li> </ol>

	<p>4- Biznes, Administrim dhe Ligj</p> <p>5- Shkenca natyrore, Matematikë dhe Statistikë</p> <p>6- Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit</p> <p>7- Inxhinieri, Prodhim dhe Ndërtim</p> <p>8- Bujqësi, Pyje, Peshkim dhe Veterinari</p> <p>9- Shëndet dhe mirëqenie</p> <p>10- Shërbime</p>
3.3. Mbulimi i sektorit	<p>Arsimi paraqitet në katër aktivitetet kryesore të tij: regjistrime dhe diplomime të nxënësve dhe studentëve përkatësisht në arsimin parauniversitar dhe atë universitar, institucionet e përfshira në arsim si dhe stafin mësimdhënës.</p>
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p><b>Arsimi parauniversitar</b> përfshin arsimin që kryhet nga institucionet arsimore si kopshte, shkolla 9 vjeçare dhe të mesme.</p> <p><b>Arsimi 9 vjeçar</b> ose arsimi bazë përbëhet nga dy cikle: cikli i ulët ose arsimi fillor i cili kryhet në klasat 1-5 dhe cikli i lartë ose arsimi i mesëm i ulët i cili kryhet në klasat 6-9. Arsimi 9 vjeçar është i detyruar, fillon në moshën 6 vjeç dhe zgjat 9 vjet. Nxënësi është i detyruar të ndjekë arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç.</p> <p><b>Arsimi i mesëm</b> përfshin gjimnazin, arsimin social-kulturor dhe arsimin profesional i cili ndahet në të ulët teknik dhe të lartë.</p> <p><b>Mësues</b> janë përcaktuar personat, aktiviteti profesional i të cilëve, përfshin transmetimin e njohurive, sjelljeve dhe aftësive që janë përcaktuar në programin arsimor tek nxënësit dhe studentët e regjistruar në institucionet zyrtare arsimore.</p> <p><b>Institucion arsimor publik</b> klasifikohet si i tillë nëse aktiviteti i tij kontrollohet plotësisht nga autoriteti arsimor publik.</p> <p><b>Raporti i regjistrimit bruto – GER</b>, është numri i të regjistruarve në një nivel të caktuar të arsimit, pavarësisht nga mosha, e shprehur si përqindje e popullsisë zyrtare në moshë shkollore, që korrespondon me të njëjtin nivel të arsimit.</p> <p><b>Raporti i regjistrimit neto – NER</b>, është numri i përgjithshëm i nxënësve në grupmoshën teorike për një nivel të caktuar të arsimit të regjistruar në atë nivel, i shprehur si përqindje e popullsisë në atë grupmoshë.</p> <p><b>Raporti nxënës për mësues</b> është raporti i numrit të nxënësve të regjistruar në një nivel të caktuar të arsimit me numrin e mësuesve në të njëjtin nivel.</p> <p><b>Raporti nxënës për mësues</b> llogaritur për qark në arsimin 9 vjeçar tregon numrin mesatar të nxënësve të regjistruar në shkollat e një qarku që i përkasin një mësuesi të qarkut, llogaritur veç për arsimin publik ose privat. Për arsimin e mesëm ky tregues llogaritet duke marrë parasysh të regjistruarit në sistemin me</p>

	<p>kohë të plotë.</p> <p><b>Indeksi i barazisë gjinore</b> i barabartë me 1 tregon barazinë midis femrave dhe meshkujve. Në përgjithësi, një vlerë më pak se 1 tregon një pabarazi në favor të djemve dhe një vlerë më e madhe se 1 tregon një pabarazi në favor të vajzave.</p> <p><b>Studentë që studiojnë jashtë vendit</b> janë personat që kanë kaluar kufirin kombëtar ose territorial me qëllim arsimimin dhe janë regjistruar në arsimin e lartë jashtë vendit të tyre të origjinës. Vendi i origjinës së nxënësve në arsimin e lartë përcaktohet nga shteti në të cilin ata kanë fituar kualifikimin e mesëm, që u jep mundësi të ndjekin arsimin e lartë.</p> <p><b>Arsimi profesional</b> përfshin programet e arsimit të dizenuara me qëllim përfitimin e njohurive, shkathtësitë dhe kompetencat specifike për një profesion të veçantë, klasë të profesioneve, ose tregti.</p> <p><b>I diplomuar në një program arsimor</b>, është një nxënës ose student, i cili ka përfunduar në mënyrë të suksesshme të gjitha kërkesat e programit.</p> <p><b>Raporti bruto i diplomimit</b> është numri i të diplomuarve pavarësisht moshës në një nivel ose program të caktuar, të shprehur si përqindje e popullsisë në moshën e diplomimit teorik, për atë nivel apo program.</p>
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore janë fëmijë, nxënës, studentë, institucion arsimor si kopësht, shkollë, institucion i arsimit të lartë, mësues- staf mësimdhënës, etj.
3.6. Popullata statistikore	Fëmijë, nxënës dhe studentë të regjistruar në arsimin zyrtar publik dhe privat, nxënës dhe studentë të diplomuar në arsim sipas niveleve arsimore, staf mësimdhënës edukatore, mësues dhe pedagogë, institucione arsimore publike dhe private.
3.7. Zona e referencës	Të dhënat e përmbledhura janë në nivel qarku dhe vendi.
3.8. Mbulimi në kohë	Shumica e të dhënave janë të disponueshme që nga viti 1990.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	Regjistrimi i fëmijëve, nxënësve ose studentëve në arsim, raporti bruto i regjistrimit sipas niveleve arsimore (kopësht, arsim fillor, arsim i mesëm i ulët, arsim mesëm i lartë, arsimi i lartë), raporti neto i regjistrimit sipas niveleve arsimore, raporti i nxënësve për një mësues, etj.
5. Periudha e referencës	Ky raport i referohet vitit 2020.
<b>6. Mandati institucional</b>	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Në nivel kombëtar, Statistikat e arsimit janë bazuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Ligjin nr. 17/2018</a> “Për Statistikat Zyrtare”.</li> <li>• <a href="#">Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare</a> për periudhën 2017-2021</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Memorandum me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.</li> </ul>
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	<p>INSTAT transmeton rregullisht në UNESCO - UIS të dhëna të detajuara mbi arsimin parauniversitar dhe atë universitar, nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve të hartuar paraprakisht nga ky institucion ndërkombëtar. Të dhënat mbulojnë arsimin parauniversitar dhe atë universitar dhe jepen të detajuara sipas çdo programi, publik/privat, gjinisë, moshave etj.</p>
<b>7. Konfidencialiteti</b>	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat konsiderohen konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>Të dhënat publikohen në nivel të agreguar. Të dhënat nuk publikohen asnjëherë në nivel individual.</p>
<b>8. Politika e botimit</b>	
8.1. Kalendarin e publikimeve	<p>Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.</p>
8.2. Aksesin në kalendarin e publikimeve	<p><a href="#">Kalendari</a> i publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.</p>
8.3. Aksesin e përdoruesve	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikat zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individi, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta.</p> <p>Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Website – online release;</li> <li>2. Kërkesat e shkruara;</li> <li>3. Publikimet e Regjistrimeve dhe Diplomimeve;</li> <li>4. <a href="#">Kërkesa për të dhëna</a>, seksioni për përdoruesit e jashtëm.</li> </ol>

<b>9. Shpeshhtësia e shpërndarjes</b>	Shpërndarja e të dhënave të arsimit bëhet në baza vjetore.
<b>10. Aksesi në të dhëna dhe qartësia</b>	
10.1. Njoftim për media	<p>Njoftimi për shtyp mbi regjistrimet përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë të regjistrimeve të arsimit si p.sh. Pjesëmarrja bruto dhe neto e nxënësve dhe studentëve në vitin shkollor/akademik, raportin nxënës për një mësues, regjistrimet sipas niveleve arsimore, etj.</p> <p>Njoftimi për shtyp mbi diplomimet përmban informacion në lidhje me të diplomuarit sipas niveleve arsimore, raportin bruto të diplomimit në arsimin e mesëm, të diplomuarit sipas fushave të studimit në arsimin e lartë, etj.</p> <p>Njoftimi për shtyp për <a href="#">“Statistikat e Arsimit”</a> publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.</p>
10.2. Publikime	<p>Përdoruesit mund t’i gjejnë publikimet mbi Statistikat e Arsimit në faqen e internetit të INSTAT të organizuara si më poshtë:</p> <p>Vjetore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Burrat dhe Gratë në Shqipëri</a></li> <li>• <a href="#">Shqipëria në shifra</a></li> <li>• Vjetari statistikor</li> <li>• <a href="#">Vjetari Rajonal Statistikor</a></li> </ul> <p>Botim i dedikuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Statistika të Regjistrimeve</a></li> <li>• <a href="#">Statistika të Diplomimeve</a></li> </ul>
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të dhënat mbi statistikat e arsimit publikohen në faqen zyrtare të INSTAT në seksionin <a href="#">Databaza</a> .
10.4. Aksesi në të dhënat mikro	Të dhënat e arsimit nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Këto të dhëna i jepen përdoruesve në rast se nuk janë konfidenciale bazuar në nenin 31 Ligji Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet këtij seksioni të dedikuar për <a href="#">kontakt</a> .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	<p>Të dhënat janë siguruar nga burime administrative në vend si Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si edhe ajo e Financave dhe Ekonomisë.</p> <p>Një shpjegim i shkurtër rreth përkufizimeve dhe <a href="#">Metodologjisë</a> për statistikate arsimit, i vihet në dispozicion përdoruesve në fund të publikimeve si edhe në</p>

	Press Release-t e Regjistrimeve dhe Diplomimeve.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Të gjitha punët rreth statistikave të arsimit janë të dokumentuara sipas proceseve dhe procedurave të punës.
<b>11. Manaxhimi i cilësisë</b>	
11.1. Sigurimi i cilësisë	<p>INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “PËR STATISTIKAT ZYRTARE, Nr. 17/2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.</p>
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Burimi i të dhënave për Statistikat e Arsimit është administrativ. Të dhënat krahasohen me të dhënat e viteve të mëparshme për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.
<b>12. Rëndësia</b>	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e statistikave të arsimit klasifikohen si të jashtëm dhe të brendshëm.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdoruesit e jashtëm janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Institucionet e Administratës Publike;</li> <li>○ Universitetet;</li> <li>○ Bizneset,</li> <li>○ Publiku i përgjithshëm dhe grupet e tjera të interesit;</li> <li>○ Organizata kombëtare jofitimprurëse;</li> <li>○ Disa tregues kryesorë dërgohen në Eurostat në pyetësin Enlargment;</li> <li>○ Informacion shumë i detajuar dërgohet në UNESCO-UIS, etj.</li> </ul> </li> <li>• Përdoruesit e brendshëm janë sektorët brenda INSTAT të cilët përdorin Statistikat e Arsimit si input për punën e tyre.</li> </ul> <p>Qëllimi kryesor i prodhimit të Statistikave të Arsimit është sigurimi i një informacioni më të plotë për shkak të rëndësisë sociale që mbartin këto statistika si dhe për nevojat e publikut lidhur me to.</p>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Page Views (Klikime) në lidhje me Arsimin për vitin 2020 janë rreth 12,022 klikime.</p> <p>Gjatë 2020 INSTAT ka kryer vërtetimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve</p>



	<p>nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e Statistikave të Arsimit është vlerësuar me 3.69 (73.8%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).</p> <p>INSTAT organizon cdo vit <a href="#">Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve</a>.</p>								
12.3. Plotshmëria	<p>INSTAT transmeton në UNESCO –UIS pyetësorë me të dhëna të detajuara arsimore të regjistrimeve, diplomimeve, stafit mësimdhënës, institucioneve arsimore, programeve arsimore dhe kohëzgjatjes së tyre etj.</p> <p>Shkalla e Plotshmërisë për Statistikat e Arsimit, për vitin 2020 rezulton të jetë 100%.</p>								
<b>13. Saktësia dhe besueshmëria</b>									
13.1. Saktësia e përgjithshme	Informacioni mbi “Statistikat e Arsimit” grumbullohet nga burimet administrative dhe të dhënat janë finale.								
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet pasi është burim administrativ.								
13.3. Gabim jo i kampionimit	Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi apo ndonjë gabimi të mundshëm njerëzor. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit. Gabimet e jo kampionimit trajtohen bazuar në politikën e trajtimit të gabimeve.								
<b>14. Afatet kohore dhe përpikmëria</b>									
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet publikohen 134 ditë pas vitit referencë (T+134 ditë), në përputhje me kalendarin e publikimeve.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2020</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>5/14/2021</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>134</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2020	Data e publikimit	5/14/2021	Afatet kohore	134		
Periudha referuese	12/31/2020								
Data e publikimit	5/14/2021								
Afatet kohore	134								
14.2. Përpikmëria	<p>Të gjitha afatet kohore respektohen në datat e paracaktuara në kalendarin . Publikimi i të dhënave si pjese e botimeve të ndryshme të INSTAT, ka qenë i përpiktë në kohë në masën 100% të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2020</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>5/14/2021</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>5/14/2021</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2020	Data e shpallur	5/14/2021	Data e publikimit	5/14/2021	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2020								
Data e shpallur	5/14/2021								
Data e publikimit	5/14/2021								
Vonesa në kohë	0								
<b>15. Koherenca dhe Krahasueshmëria</b>									
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Statistikat e Arsimit paraqiten në nivel prefekturë dhe vendi. Këto statistika janë								

	<p>relativisht të krahasueshme pasi institucionet që na sigurojnë të dhënat koordinojnë procesin e mbledhjes së të dhënave.</p> <p>Gjithashtu në nivel ndërkombëtar sigurohet krahasueshmëria e tyre e cila bëhet e mundur me dërgimin e të dhënave dhe statistikave të arsimit në institucione ndërkombëtare dhe evropiane. Kushti kryesor që siguron krahasueshmërinë është përdorimi i klasifikimit ndërkombëtar <a href="#">ISCED-2011</a> në Statistikat e Arsimit në Shqipëri.</p>
15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Statistikat e Arsimit datojnë që nga viti 1991 referuar databazës statistikore.</p> <p>Nga viti 2004, të dhënat e arsimit parauniversitar sigurohen sipas një formati të caktuar elektronik të përcaktuar nga burimi administrativ dhe INSTAT, ndërsa ato të arsimit universitar, që prej vitit 2008, duke siguruar një krahasueshmeri kohore respektivisht prej 17 dhe 13 vitesh.</p>
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet pasi është burim administrativ.
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohet para se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri të ndryshme.
<b>16. Kostoja dhe ngarkesa</b>	Stafi i përfshirë në përgatitjen e Statistikave të Arsimit pranë sektorit të Zhvillimit të Statistikave Sociale, në drejtorinë e Statistikave Sociale është: 1 punonjës.
<b>17. Rishikimi i të dhënave</b>	
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit të statistikave të arsimit bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Politika e Revizionimit</a></li> <li>• <a href="#">Politika e Trajtimit të Gabimeve</a></li> </ul>
17.2. Praktika e rishikimit	Në rast ndryshimesh në pyetësorët që dërgohen në UNESCO për statistikave të arsimit, INSTAT bën rishikime në të dhënat dhe ridërgon pyetësoret me ndryshimet dhe shpjegimet përkatëse.
<b>18. Përpunimi statistikor</b>	
18.1. Burimi i të dhënave	Të dhënat bazohen në burime administrative. Ofruesit kryesorë të të dhënave të arsimit janë: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si edhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
18.2. Shpeshësia e grumbullimit të të	Të dhënat e arsimit në lidhje me regjistrimet mbledhen në bazë vjetore me fillimin e shkollës ose institucioneve arsimore. Gjithashtu të dhënat e arsimit në

dhënavë	lidhje me diplomimet mblidhen në bazë vjetore, në përfundim të vitit shkollor ose akademik.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Instituti i Statistikave organizon punën për llogaritjen e treguesve dhe statistikave të arsimit, e orientuar nga Programi i Statistikave Zyrtare dhe Ligji i Statistikës. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë është burimi kryesor i të dhënave për të gjitha nivelet e arsimit zyrtar që kryhet në vend sipas këtij programi. Po ashtu Ministria e Financave dhe Ekonomisë është burimi i të dhënave për arsimin profesional. Programi përmban një sistem pasqyrash, që plotësohen me të dhëna sasiore nga të gjitha institucionet arsimore, të mbledhura në mënyrë periodike, në bazë të një metodologjie të caktuar si edhe të përvojës së gjatë kombëtare. Në mbledhjen dhe përpunimin e statistikave të arsimit shqiptar përdoret klasifikimi ndërkombëtar standard i arsimit ISCED, aplikuar fillimisht varianti i vitit 1997, dhe që nga viti 2013 ISCED-2011, sipas rekomandimeve edhe të Eurostat dhe UNESCO-s.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Kontrollet logjike dhe matematikore aplikohen në të dhënat administrative të arsimit. Ndër metodat e verifikimit të dhënave administrative mund të përmendim: Kontrolli për plotësinë e të dhënave, konsistenca me kalimin e kohës, korrigjimet aritmetike (nuk duhet të jenë shumë të larta), kontrollet përmbledhëse, kontrolli i serive kohore nëse ka devijime të mëdha, etj.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet. Mbulimi është gjithë përfshirës në nivel vendi dhe prefekturë, të dhënat janë administrative dhe informacioni statistikor mundësohet përherë në kohë, prandaj vlerësimi i të dhënave nuk është i nevojshëm.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
<b>19. Komentë</b>	
<b>Aneks</b>	